

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS  
PKL-KZZ- 73/2010  
2 Prill 2012

## NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë prej Gjyqtarit të EULEX-it Martti Harsia si Kryetar i kolegjit, Gjyqtarit të EULEX-it Elka Filcheva-Ermenkova, me Gjyqtarët Kosovarë të Gjykatës Supreme të Kosovës, Nesrin Lushta, Salih Toplica dhe Avdi Dinaj, si anëtarë të kolegjit, në praninë e Adnan Isufi Këshilltar ligjor i EULEX-it Legal, në cilësi të procesmbajtësit, në lëndën penale të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë kundër të miturit:

M S , i lindur më në , emri i të atit  
emri i së ëmës  
në


I ngarkuar për vepër penale të Vrasjes së rëndë, në kundërshtim me Nenin 30 paragrafin 2 nën-paragrafët 1,2,3 dhe 5 dhe paragrafin 3 të Ligjit Penal të Kosovës (LPK) lidhur me Nenin 24 të Kodit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (KP RSFJ), dhe të Vrasjes së rëndë në tentativë, në kundërshtim me Nenin 30 paragrafin 2 nën-paragrafët 1,2,3 dhe 5 dhe paragrafin 3 të LPK-së lidhur me Nenin 24 të KP RSFJ-së, të dënueshme sipas Nenit 30 paragrafit 2 pikës 3 të LPK-së, lidhur me Nenin 19 të KP RSFJ-së, dhe Pjesëmarrje në grup që kryen vepër ose vepra penale në kundërshtim me Nenin 200 paragrafin 1 të LPK-së;

Duke vendosur mbi Kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të paraqitur nga Avokati mbrojtës Zivojin Jokanovic në emër të të miturit M Si , kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë P nr 573/08, të datës 10 shkurt 2009, kundër Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Ap-Kz 198/2009, të datës 3 mars 2010,

Në përputhje me Nenin 454 paragrafin 1 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (*tash e tutje "KPPK"*), dhe Nenit 51 paragrafi 2 dhe Neni 79 të Kodit të Drejtësisë për të mitur të Kosovës (*tash e tutje "JJCK"*) pas seancës së këshillimit dhe votimit të mbajtur më 2 Prill 2012, Gjykata Supreme e Kosovës lëshon këtë:

### AKTGJYKIM

Kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e paraqitur nga avokati mbrojtës Zivojin Jokanovic në emër të të miturit M S , kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë P nr 573/08, të datës 10 shkurt 2009, kundër Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Ap-Kz 198/2009, të datës 3 mars 2010, refuzohen si të pabazuara dhe Aktgjykimi i Gjykatës Supreme vërtetohet në përputhje me Nenin 456 të KPPK-së.



## ARSYETIMI

### I. HISTORIA E PROCEDURËS

Më 18 nëntor 2008, Prokurori Publik Ndërkombëtar parashtrioi një mendim dhe propozimin akuzues kundër të miturit M. S. Prokurori Publik pretendon se më 15 qershor 1999 i mituri Marko Simonovic në bashkëpunim me të dyshuarit J. B., I. R., D. C. dhe të tjerët, në mënyrë të organizuar dhe në mbështetje të ndërmarrjes së përbashkët penale të motivuar nga urrejtja etnike, kanë vrarë katër Shqiptarë të Kosovës, përkatësisht A. B., U. A., V. B. dhe N. G., në kundërshtim me Nenin 30 paragrafin 3 lidhur me paragrafin 2, pikën 3 të Ligjit Penal të Kosovës. Prokurori Publik më tutje pretendon se më 15 qershor 1999 i mituri M. S. në bashkëpunim me të dyshuarit J. B., I. R., D. C. dhe të dyshuar të tjerë, në mënyrë të organizuar dhe në mbështetje të ndërmarrjes së përbashkët penale, të motivuar nga motivet e ulëta të urrejtjes etnike, kanë kryer vrasje në tentativë ndaj dy Shqiptarëve të Kosovës, përkatësisht Z. G. dhe A. G. në kundërshtim me Nenin 30 paragrafin 3 lidhur me paragrafin 2, pikën 3 të Ligjit Penal të Kosovës, lidhur me Nenin 19 të Kodit Penal të Jugosllavisë. Në fund prokurori publik thekson se më 15 qershor 1999 i mituri M. S. bashkërisht ka marrë pjesë në grup me J. B., I. R., D. C. dhe të tjerët, që kryen veprë penale ose vepra penale duke ua marrë jetën A. B., U. A., V. B. dhe N. G., në kundërshtim me Nenin 200 (1) të Kodit Penal të Kosovës.

Më 10 shkurt 2009 Gjykata e Qarkut në Prishtinë shpalli të miturin M. S. fajtor për kryerje të veprave penale të Vrasjes së rëndë të katër njerëzve, në kundërshtim me Nenin 30 paragrafin 2 nën-paragrafët 1,2,3 dhe 5 dhe paragrafin 3 të LPK-së lidhur me Nenin 24 të KP RSFJ-së, të Vrasjes së rëndë në tentativë të dy njerëzve, në kundërshtim me Nenin 30 paragrafin 2 nën-paragrafët 1,2,3 dhe 5 dhe paragrafin 3 të LPK-së lidhur me Nenin 24 të KP RSFJ-së, të dënueshme sipas Nenit 30 paragrafit 2 pikës 3 të LPK-së, lidhur me Nenin 19 të KP RSFJ-së, dhe Pjesëmarrje në grup që kryen veprë ose vepra penale në kundërshtim me Nenin 200 paragrafin 1 të LPK-së.

Gjykata e shkallës së parë të miturit i shqiptoi një dënim unik në kohëzgjatje prej dhjetë (10) vjetësh burgim për dy akuzat e para kurse për akuzën e tretë edhe pse i mituri është shpallur fajtor, gjykata nuk i shqiptoi asnjë dënim pasi që gjykata konsideroi se kjo akuzë është konsumuar në dy akuzat e para. Koha e kaluar në paraburgim do t'i llogaritet dhe përfshihet në kohëzgjatjen e dënimit.

Më 3 mars 2010, Gjykata Supreme e Kosovës pjesërisht ka miratuar ankesën e të miturit M. S. të paraqitur përmes avokatit mbrojtës Zivojin Jakonovic dhe ka ndryshuar aktgjykimin e kundërshtuar të gjykatës së shkallës së parë. I mituri M. S. është shpallur fajtor për një veprë penale Ndhimë në kryerjen e vrasjes së rëndë, në kundërshtim me Nenin 30, par. 2, nënpar. 1, 2, 3 dhe 5 dhe par. 3 të LPK-së, lidhur me Nenin 24 të KP të RSFJ-së,

dhe për një vepër penale Vrasje e rëndë në tentativë, në kundërshtim me Nenin 30, par. 30, par. 2, nënpar. 1, 2, 3 dhe 5 dhe par. 3 të LPK-së, lidhur me Nenin 24 të KP të RSFJ-së. Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut të Prishtinës, i datës 10 shkurt 2009, P. Nr. 573/2009, është vërtetuar sa u përket pjesëve tjera. Dënimi i shqiptuar ndaj të pandehurit ulet në një dënim të vetëm me burgim prej gjashtë (6) vjetësh burgim.

Avokati mbrojtës Zivojin Jakonovic në emër të të miturit ka ushtruar Kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë ndaj Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut të Prishtinës P. Nr. 573/08 të datës 10 shkurt 2009, kundër Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës Ap-Kz 198/2009, të datës 3 mars 2010. Avokati mbrojtës ka kërkuar ndryshimin e aktgjykimeve të kundërshtuara; lirimin e të miturit nga të gjitha akuzat penale dhe kthimin e lëndës për rishqyrtim në gjykatën e shkallës së parë.

Lënda u dërgua për marrjen e mendimit të ZPShK-së.

Përmes shkresës KMLP Nr. 75/2010 të datës 7 shtator 2010, Zyra e Prokurorit të Shtetit ka paraqitur mendimin dhe ka propozuar që kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë të refuzohet si e pabazë.

## II. GJETJET E GJYKATËS SUPREME

Gjatë vlerësimit të Kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë, Gjykata Supreme e Kosovës ka konstatuar si vijon:


a. Kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë është e pranueshme. Kjo kërkesë është paraqitur në gjykatën kompetente në pajtim me Nenin 454, par. 1 dhe brenda afatit ligjor sipas Nenit 452, par. 3 të KPPK-së.

b. Gjykata Supreme e Kosovës ka vendosur në seancën e përcaktuar me Nenin 454, par. 1 të KPPK-së. Njoftimi i palëve rreth kësaj seance nuk ka qenë i nevojshëm.

c. Kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë është e pabazuar.

Kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë pretendon shkelje esenciale të Ligjit të Procedurës Penale të Kosovës (me poshtë në tekst "LPPK") si dhe shkelje të tjera të LPPK-së të cilat ndikojnë në ligjshmërinë e Aktgjykimit.

Gjykata Supreme e Kosovës konstaton se pjesë të caktuara të Kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë i referohen në masë të madhe vërtetimit të gjendjes faktike. Gjykata Supreme e Kosovës megjithatë kufizohet në vlerësimin e vet nga Neni 451 dhe Neni 455 i KPPK-së, të cilët parashohin që avokati mbrojtës nuk mund të paraqesë Kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë për shkak të vërtetimit të gabueshëm ose jo të plotë të gjendjes faktike. Rrjedhimisht, kontestimi i gjendjes faktike në këtë fazë të procedurës është i papranueshëm.



Në vlerësimin e vet, Gjykata Supreme e Kosovës nuk gjen asnjë gabim procedural në aktgjykimet e kundërshtuara, i cili do të duhet të merrej parasysh sipas detyrës zyrtare. Në pajtim me këtë, sipas Nenit 455 të KPPK-së, Gjykata Supreme e Kosovës kufizohet në shqyrtimin e atyre shkeljeve të ligjit material dhe atij procedural, të cilat pretendohen se janë bërë nga ana e parashtruesit në kërkesën e tyre.

Në Kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, avokati mbrojtës pretendon si vijon:

#### A. ZBATIMIN E GABUESHËM TË KODIT PENAL TË KOSOVËS

1. Avokati mbrojtës pretendon se ka pasur shkelje të ligjit material pasi që krimi për të cilin bën fjalë Neni 30, par. 2 i LPK-së përcakton vrasje dhe jo vrasje të rëndë. Krimi i vrasjes së rëndë nuk ekziston si i tillë në LPK. Për këtë arsye, avokati mbrojtës pretendon se është bërë cilësim i gabuar juridik i veprës penale në fjalë.

Gjykata Supreme konstaton se qëndron fakti që “Vrasja e rëndë” siç është përdorur në mënyrë evidente në aktgjykimet e kundërshtuara nuk ekziston në LPK, dhe kjo gjë është përmendur me të drejtë nga avokati mbrojtës në Kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë.


Neni 30 i LPK-së përcakton:

- (1) *Kush tjetrin e privon nga jeta, dënohet me burgim jo më pak se pesë vjet.*
- (2) *Me burgim jo më pak se dhjetë vjet ose me dënim me vdekje do të dënohet:*

- 1) *kush tjetrin në mënyrë mizore ose dinake e privon nga jeta;*
- 2) *kush tjetrin e privon nga jeta dhe me atë rast me dashje e vë në rrezik jetën edhe të një personi tjetër;*
- 3) *kush tjetrin e privon nga jeta për interes, për të kryer ose për të fshehur veprën tjetre penale, për shkak të hakmarrjes së paskrupullt, ose nga motivet e tjera të dobëta;*
- 4) *kush tjetrin e privon nga jeta për gjakmarrje;*
- 5) *kush tjetrin e privon nga jeta me sjellje të paskrupullt huligane;*
- 6) *kush tjetrin e privon nga jeta personin zyrtar ose ushtarakun me rastin e kryerjes së punëve të sigurimit publik ose të detyrës së ruajtjes së rendit publik, kapjes së kryesit të veprës penale ose të ruajtjes së personave që u është hequr liria, ose kush privon nga jeta personin i cili në bazë të ligjit ose të ndonjë dispozite tjetër kryen këto punë në realizimin e vetëmbrojtjes shoqërore.*

(3) *Me dënimin nga paragrafi 2 i këtij neni do të dënohet edhe kush me dashje ka bërë disa vrasje, përveç atyre që janë parashikuar në nenet 33 dhe 34 të këtij ligji, pa marrë parasysh se a gjykohet për të gjitha vrasjet me zbatimin e dispozitave mbi bashkimin ose ka qenë i dënuar më parë për ndonjë vrasje tjetër.*

Neni 30 paragrafi 1 i LPK-së përcakton përkufizimin e vrasjes si “*kush tjetrin e privon nga jeta*” pa i specifikuar rrethanat në të cilat është kryer vepra, qofshin ato për nga natyra **rënduese dhe**




/ose lehtësuese. Paragrafi 2, pikat 1 – 6 të këtij neni përkufizojnë cilësimin e formave të (rënda ) të vrasjes. Kjo në literaturë njihet si “Vrasje e rëndë” kur vepra kryhet në njërin nga rrethanat rënduese të përcaktuara me ligj. Rrethanat e tilla të cilat e bëjnë vrasjen të kualifikuar janë për shembull ato që kanë të bëjnë me mënyrën e kryerjes së vrasjes, kryerjes së vrasjes në mënyrë mizore dhe të dhunshme, rrezikimi i jetës së personit tjetër, motivet e ulëta të kryerësit, rolin të subjektit pasiv gjatë kryerjes së detyrave të caktuara zyrtare dhe numrin e personave të cilëve u është marrë jeta.

Ndryshe nga teoria, LPK-ja përcakton vetëm përkufizimin e vrasjes, pavarësisht nga rrethanat në të cilat është kryer vepra. Prandaj, ngritët pyetja nëse indikacioni i frazës “rëndë” në aktgjykimet e kundërshtuara, edhe pse në fakt i pandehuri është shpallur fajtor për veprat e kryera në rrethana rënduese, përbën shkelje të ligjit penal pasi që krimi i përmbajtur në nenin 30 paragrafin 2 të LPK-së është vetëm vrasje e kryer në njërin nga rrethanat rënduese dhe jo vrasje e rëndë.

Gjatë adresimit të kësaj pike, Gjykata Supreme vëren se edhe pse instancat e mëparshme gabimisht kanë përdorë frazën “e rëndë”, ky “defekt” është i paefektshëm *Inritus Irritus* sa i përket cilësimit të veprës penale. Kjo është e vërtetë posaçërisht për shkak se aktgjykimet e kundërshtuara në mënyrë adekuate i referohen dispozitave ligjore të ligjit penal duke e mos lënë hapësirë për dyshime sa i përket dispozitave të zbatuara të ligjit penal. Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Prishtinë i datës 10 shkurt 2009, thotë se i mituri M. S. është shpallur fajtor për kryerjen e veprave penale Vrasje e rëndë nga neni 30 paragrafi 2 nën-paragrafët 1, 2, 3 dhe 5 të LPK-së në lidhje me nenin 24 të KP të RSFJ-së, Vrasje të rëndë në tentativë nga neni 30, paragrafi 2, nën-paragrafët 1, 2, 3, 5 dhe paragrafi 3 i LPK-së në lidhje me nenin 24 të KP të RSFJ-së, të dënueshme sipas nenit 30 paragrafit 2, pikës 3 të LPK-së, në lidhje me nenin 19 të KP të RSFJ-së, Pjesëmarrje në grup që kryen vepër penale nga neni 200 paragrafi 1 i LPK-së. Më tutje, aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës i datës 3 mars 2010 thekson se i pandehuri është shpallur fajtor për Ndihmë në kryerjen e vrasjes së rëndë të një personi në kundërshtim të nenit 30 paragrafit 2, nën-paragrafëve 1, 2, 3 dhe 5 dhe paragrafit 3 të LPK-së në lidhje me nenin 24 të KP të RSFJ-së, e dënueshme sipas nenit 30 paragrafit 2, pikës 3 të LPK-së në lidhje me nenin 19 të KP të RSFJ-së, dhe , Pjesëmarrje në grup që kryen vepër penale ose vepra nga neni 200 paragrafi 1 i LPK-së.

Gjykata Supreme e Kosovës gjen se instancat e mëparshme i kanë bërë referencë adekuate dispozitave ligjore të ligjit material. Nuk ka asnjë dyshim se për të cilat vepra penale është dënuar i mituri M. S. “Defekti” përdorimi i frazës “rëndë” është kryesisht *lingua errori* i cili ka të bëjë me çështjet jo-esenciale të cilat nuk ndikojnë në cilësimin e veprës penale, ose përkeqësojnë pozitën penale juridike të të miturit apo ndryshojnë identitetin e akuzës. Rrjedhimisht, nuk është arsye për anulimin e aktgjyimit.

2. Avokati mbrojtës pohon se Gjykata Supreme nuk ka marrë parasysh veprimet aktuale të të miturit të cilat përbëjnë Ndihmë në vrasje dhe vrasje në tentativë dhe nuk është marrë parasysh dashja penale e të miturit. Avokati mbrojtës pohon se gjykatat në instancat e



mëparshme nuk kanë ofruar arsyetim se si, me çfarë veprime, i mituri ka ndihmuar në kryerjen e veprave penale.

Gjatë adresimit të kësaj pike Gjykata Supreme gjen se avokati mbrojtës ngrit dyshime lidhur me ekzistimin e fakteve relevante të lëndës të cilat në të vërtetë kanë të bëjnë me pretendimin e vërtetimit jo të plotë të gjendjes faktike. Sidoqoftë, kontestimi i aktgjykimit mbi bazën e gjendjes faktike në këtë fazë të procedurës është e papranueshme sipas nenit 451 (2) të KPPK-së. Ky qëndrim është marrë vazhdimisht nga Gjykata Supreme e Kosovës në lëndë të ndryshme. Për shembull, në lëndën Runjeva dhe Dema (*Gjykata Supreme e Kosovës, AP-KZ, data 25 janar 2008, faqe 20*), Gjykata Supreme e Kosovës në këtë kontekst ka theksuar se *“procedura ankimore në KPPK mbështetet në parimin se është detyrë e trupit gjykues që të dëgjoj, vlerësojë dhe peshojë provat në gjykim [...] Prandaj, Gjykata e apelit duhet t’i jap hapësirë trupit gjykues në arritjen e gjetjeve të tyre faktike. Nuk duhet t’i trazojë gjetjet e trupit gjykues apo t’i zëvendësoj ato me të vetat, përveç nëse provat në të cilat është bazuar trupi gjykues nuk do të pranoheshin nga asnjë gjykatë e arsyeshme e faktit ku vlerësimet e saj kanë qenë “tërësisht të gabuara”.*


Në lëndën në fjalë, nuk janë gjetur mangësi të tilla të cilat do të obligonin në prishjen e aktgjykimeve të kundërshtuara dhe kthimin e lëndën në rigjykim. Prandaj, ky kolegji konsideron çdo referim dhe kontestim i aktgjykimeve mbi bazën e gjendjes faktike jo vetëm të kotë por edhe të gabuar.

3. Avokati mbrojtës pretendon se gjendja faktike mohon sjelljen brutale dhe të dhunshme e cila do të hynte në kategorinë e vrasjes së rëndë. Mbrojtja pohon se urrejtja etnike, edhe pse paraqet nxitje morale negative, nuk hynë nën kategorinë e vrasjes së rëndë sipas nenit 30 paragrafit 2 të LPK-së.

Gjatë adresimit të kësaj pike, sa i përket motivit/eve të mundshme të cilat e kanë shtyrë të miturin në kryerjen e veprës penale, ky kolegji vëren se motivi i krimit nuk është/janë pjesë e vetë veprës siç është përkufizuar në ligj. Derisa rëndësia e motiveve është e padiskutueshme veçanërisht në lidhje me përcaktimin e qëllimit të një krimi dhe rrjedhimisht të nivelit të përgjegjësisë, si dhe përcaktimit të masave kufizuese dhe gjatësisë së dënimit, megjithatë motivet nuk janë elemente përbërëse të figurës së veprave penale për të cilat i mituri është shpallur fajtor. Si rrjedhojë, ky kolegji e konstaton të tepërt çfarëdo shqyrtimi të mëtutjeshëm të kësaj pike.

4. Avokati mbrojtës pohon se gjykata nuk e ka konsideruar si duhet *alibinë*. Prindërit dhe motrat e tij të cilët edhe pse jo sigurt do të konfirmonin alibinë.

Gjatë adresimit të pretendimeve të ankuesit, ky kolegji vëren se gjykata e shkallës së parë vlerësoi provat dhe dëgjoi dëshmitë e propozuara nga palët në procedurë, respektivisht prokurori publik dhe avokati mbrojtës. Është evidente se mbrojtësit i janë dhënë mundësi të mjaftueshme për të kundërshtuar provat e paraqitura gjatë shqyrtimit gjyqësor. Fakti që gjykata ndanë pikëpamje të ndryshme me avokatin mbrojtës për vendndodhjen e të miturit



gjatë zhvillimit të ngjarjeve, nuk shërben si argument për të konkluduar vërtetim të gabuar të gjendjes faktike. Pretendimet e tilla tashmë janë adresuar dhe janë trajtuar siç duhet në shkallët e mëhershme. Gjykata Supreme Kosovës nuk gjen asgjë të re nga pretendimet e mëhershme të ngritura nga avokati mbrojtës që do të dobësonte bazën e përgjithshme faktike të akuzave. Gjykata Supreme e Kosovës vëren se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë bën një referim të duhur tek provat në të cilat është mbështetur e të cilat janë siguruar, administruar dhe vlerësuar si duhet nga gjykata.

5. Në kërkesë avokati mbrojtës ngre çështjen e dënimit bazuar në Nenin 417 të LPPK. Gjykata e shkallës së dytë duke vepruar sipas ankesës e ka shqiptuar dënimin pothuajse maksimal me burgim për veprën për të cilën e kanë shpallur atë fajtor dhe kanë caktuar gjashtë vjet burgim.


Gjykata Supreme e Kosovës, me respekt, nuk pajtohet me këndvështrimin e avokatit mbrojtës në lidhje me kohëzgjatjen e dënimit. Kjo lëndë është veçanërisht serioze që kërkon një dënim të ashpër.

Ky kolegji vëren se nuk ka asnjë detyrim për gjykatën për të ulur dënimin për shkak të shfajësimin të pjesëhem dhe / ose ndryshimit të aktgjykimeve të kundërshtuara. Gjykata detyrohet vetëm me dënimin maksimal. Në të vërtetë, në shkallë të dytë, i mituri është shpallur fajtor për veprat penale Dhënie e ndihmës në kryerjen e një Vrasje të Rëndë, në shkelje të Nenit 30 par (2) nën-par 1, 2, 3 dhe 5 dhe par 3 të KPK, të lexuar bashkë me Nenin 23 të KP të RSFJ, veprën penale Vrasje e rëndë në Tentativë, në shkelje të Nenit 30 par 30 par 2 nën-par 1, 2, 3 dhe 5 dhe par 3 të LPK, të lexuar në lidhje me Nenin 24 të KP të RSFJ. Dënimi i shqiptuar ndaj të miturit është ulur në një dënim të vetëm të unifikuar me gjashtë (6) vjet burgim. Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Prishtinë i datës 10 shkurt 2009, P nr. 573/2009, është vërtetuar në pjesët e mbetura.

Duke pasur parasysh rrethanat në lidhje me lëndën, mënyrën në të cilën është kryer krimi - *modus operandi*, si edhe intensitetin e rrezikut shoqëror të veprës penale, kjo gjykatë nxjerr përfundimin se dënimi i shqiptuar është i drejtë dhe i ligjshëm, pra në përputhje me qëllimin e dënimit siç parashihet me ligj. Prandaj Gjykata Supreme konstaton se gjykata e shkallës së dytë i ka shqyrtuar plotësisht dhe drejt të gjitha rrethanat përkatëse kur ka shqiptuar llojin dhe kohëzgjatjen e dënimit.

#### **B. SHKELJE SUBSTANCIALE TË DISPOZITAVE TË PROCEDURËS PENALE DHE SHKELJE TË TJERA TË DISPOZITAVE TË PROCEDURËS PENALE**

6. Avokati mbrojtësi pohon se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është i bazuar në prova të papranueshme në atë se dëshmitarë të caktuar nuk kanë besueshmëri dhe disa nga dëshmitarët kishin motiv për të dhënë dëshmi të rreme. Kjo rezulton në shkeljen e Nenit 403 par 1, pika 8 dhe 12 të LPPK. Avokati mbrojtës argumenton dyshim serioz në besueshmërinë e dëshmitarëve sepse rrethanat e mëhershme i bëjnë ata jo të besueshëm.



Në adresimin e kësaj çështje, ky kolegji konstaton të rëndësishme të theksoj se megjithëse avokati mbrojtës shpreh shqetësime në lidhje me pranueshmërinë, në fakt, avokati mbrojtësi më tepër konteston besueshmërinë e dëshmitarëve. Në lidhje me pranueshmërinë e provave, kjo kolegji vëren se kërkesa nuk ka treguar në mënyrë specifike provën dhe / ose provat në të cilat u mbështet gjykata e të cilat avokati mbrojtësi eventualisht i konsideron se janë marrë në shkelje të rregullave të provave dhe / apo për të cilat avokatit mbrojtës nuk i është dhënë mundësia për t'i kundërshtuar. Sikurse u tha më lart, ky kolegji konstaton se avokatit mbrojtës i janë dhënë mundësi të mjaftueshme për të kundërshtuar provat e paraqitura gjatë shqyrtimit gjyqësor. Përveç kësaj ky kolegji konstaton se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë i bën një referencë të duhur provave në të cilat mbështetet e të cilat janë siguruar, administruar dhe vlerësuar si duhet nga gjykata.


Në lidhje me besueshmërinë e dëshmitarëve, në përgjithësi qëndron fakti se mospërputhjet dhe kontradiktat në dëshmitë e dëshmitarëve mund të rezultojnë nga proceset objektive dhe të zakonshme psikologjike të perceptimit të njeriut, sidomos të dëshmitarëve të cilët kanë përjetuar ngjarje traumatike dhe të cilët për shkak të rrethanave procedurale duhet të japin deklaratat e tyre për të njëjtat ngjarje. Përgjithësisht, ky këndvështrim është i pranuar. Megjithatë, ngjarjet e tilla nuk mund të shërbejnë si justifikim për përjashtim të deklaratës në mënyrë arbitrare. Besueshmëria e dëshmitarit duhet të matet dhe vlerësohet nga lënda në lëndë. Nuk mund të vihet në dyshim paraprakisht besueshmëria e një dëshmitari dhe / apo të ulet vlera provuese e tërë deklaratës bazuar në observim të përgjithshëm të situatës. Në lidhje me besueshmërinë e një dëshmitari, më tepër sesa rrethanat objektive të përgjithshme, është thelbësore të vërtetohen disa rrethana të tilla si ato që tregojnë qartë anshmëri, tendenca në pjesën e atij dëshmitari dhe / ose provat të cilat pasqyrojnë se deklarata e dëshmitarit është në kundërshtim me provat e tjera në lëndë.

Në lëndën në fjalë, ky kolegji konsideron se gjykatat i kanë gjykuar dhe vlerësuar drejt të gjitha provat në pajtueshmëri me rregullat e provave dhe i konsideron pa meritë pretendimet e parashtruara në mënyrë të përgjithësuar.

7. Avokati mbrojtës pohon se aktgjykimet e atakuara përmbajnë kundërthënie në mes të dispozitivit dhe arsytimit.

Gjatë shqyrtimit të kësaj pike, Gjykata Supreme e Kosovës, nuk ka vërtetuar asnjë kundërthënie substanciale në lidhje me dispozitivin e aktgjykimëve të ankmuara. Gjykata Supreme e Kosovës konstaton se në këtë lëndë dispozitivi i aktgjykimëve të kundërshtuara është mjaftë i qartë. Ata i referohen në mënyrë të duhur dispozitave të ligjit penal duke qartësuar në këtë mënyrë se çfarë forme e fajësisë është vërtetuar për të miturin nga gjykata.

Avokati mbrojtës nuk sjellë në mënyrë specifike se cila pjesë e dispozitivit është kundërthënëse me pjesën e arsytimit të aktgjykimëve të kundërshtuara. Kërkesa më tepër paraqet se gjendja faktike është vërtetuar gabimisht nga shkalla e parë dhe e dytë. Ky kolegji konstaton se këto pretendime nuk qëndrojnë pasi që përshkrimi faktik i ngjarjes i sjellë në dispozitiv të gjykatës së shkallës së dytë përputhet në tërësi me bazën faktike, zhvillimin e ngjarjes të theksuar në





akuzë. Duke e parë në tërësinë e saj, nuk ekziston asnjë kontradiktë dhe/ apo kundërthënie në mes të dispozitivit dhe arsytimit të aktgjykimit të kundërshtuar.

Prandaj ky kolegji argumentin e avokatit mbrojtës për kundërthënie e konstaton të pa meritë.

### **C. SHKELJE TË TJERA TË LPPK QE JANË ME NDIKIM NË LIGJSHMËRINË E AKTGJYKIMIT**

8. Avokati mbrojtës pohon në paraqitjen e tij "Vërejtje të përgjithshme" se gjykata e shkallës së parë në mënyrë substanciale ka shkelur procedurën penale duke mos përfshirë të dhënat personale të të miturit në dispozitiv.


Në adresimin e kësaj çështje, ky kolegji vëren se megjithëse Gjykata e Qarkut i referohet shkresave të lëndës, ajo gaboi kur nuk i theksoi të dhëna personale të të pandehurit sikurse kërkohet me dispozitat ligjore. Megjithatë ky gabim në zbatimin e ligjit në mënyrë të duhur është korrigjuar gjatë fazës së procedurës së apelit. Prandaj një çështje e tillë nuk është ekzistuese në këtë fazë të procedurës pasi që ajo është trajtuar në shkallën e dytë. Rrjedhimisht, ky kolegji e konstaton të tepërt çdo koment të mëtejshëm mbi këtë çështje.

### **III. KONKLUZIONI I GJYKATËS SUPREME TË KOSOVËS**

Për arsyet e lartë përmendura, Gjykata Supreme nxjerr përfundimin:

Kërkesat për mbrojtjen e ligjshmërisë të ushtruar nga avokati mbrojtës Zivojin Jokanovic në emër të të miturit M S , kundër aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë P nr. 573/08, të datës 10 shkurt 2009, kundër aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Ap. 198/2009, të datës 3 mars 2010, janë të pabazuar.

Në kuadër të kësaj që u tha më lart, Gjykata Supreme e Kosovës vendosi si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.



GJKATA SUPREME E KOSOVËS

PKL-KZZ 73/2010, data 2 prill 2012

Kryetari i kolegjit:

Procesmbajtësi:

Martti Harsia

Adnan Isufi

Gjyqtar i EULEX-it

Këshilltar ligjor i EULEX

Anëtarët e kolegjit:

Nesrin Lushta

Elka Filcheva-Ermenkova

Gjyqtare e Gjykatës Supreme


Gjyqtar i EULEX-it

Avdi Dinaj

Salih Toplica

Gjyqtar i Gjykatës Supreme

Gjyqtare e Gjykatës Supreme



Republika e Kosovës / Republika Kosovo  
GJYKATËSINË E KOPJËS E VËRTETËM  
YACHOCT OTIPRAVKA POTVRDJUJE

Udhëheqësi i Gjykatës Supreme  
*[Signature]*

**Mjeti Juridike:** Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë nuk mund të ushtrohet kundër vendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës me të cilin është vendosur mbi kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë (Neni 451 paragrafi (2) të KPPK).